



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA FUSHË-ARRËZ
KËSHILLI BASHKIAK

Përmbledhje e rekomandimeve të konsultimeve publike “Mbi draftin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2026-2028 dhe Buxhetin e vitit 2026” të Këshillit Bashkiak Fushë Arrëz

Titulli i Projekt-aktit : “Mbi draftin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2026-2028 dhe Buxhetin e vitit 2026”

Grupet që u konsultuan: Banorët e të gjitha Njësive Administrative, Kryetarët e Fshatrave dhe Ndërlidhësit Komunitarë, përfaqësues të grupeve të ndryshme të interesit, etj.

Numri i pjesëmarrësve në konsultime : 154 persona, nga të cilët 34 gra dhe vajza

Numri i rekomandimeve: 78

Rekomandimet dhe kërkesat e dhëna nga qytetarët në takimet publike janë mbi:

- Përmirësimin e infrastrukturës së shkollave,
- Përmirësimin e infrastrukturës rrugore rurale,
- Përmirësimin e shërbimeve publike ujësjellës kanalizime,
- Zgjerimi i rrjetit të ndriçimit publik
- Pastrimi i kanaleve vaditëse dhe rendeve të ujit
- Shtimi i hapësirave rekreative për të rinjtë

Të gjitha informacionet për konsultimet e publikun janë publikuara në regjistrin online për konsultimet me publikun në faqen web dhe facebook të Këshillit Bashkiak.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA FUSHË-ARRËZ
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 3755 prot.

Blerim, më 26.11.2025

PROCESVERBAL

**TEMA: KONSULTIM PUBLIK PËR PROGRAMIN BUXHETOR AFATMESEM 2026-2028,
BUXHETI I BASHKISË PËR VITIN 2026, PAKETA FISKALE 2026.**

**NJËSIA ADMINISTRATIVE BLERIM
(Zbardhur, më 27.11.2025)**

Bazuar në ligjin Nr.139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore" neni 18 pika 1, pika 2, neni 54 germa (dh), germa (f) dhe në Rregulloren për Funkcionimin e Këshillit Bashkiak Fushë-Arrëz (VKB Nr. 15, datë 27.04.2020) Neni 153, Neni 154, **u mbajt sot, më 26.11.2025, në ambientet e Njesisë Administrative Blerim, Ora 11:00, dëgjesa publike mbi "Programin Buxhetor Afatmesëm 2026-2028, buxheti i bashkisë për vitin 2026, paketa fiskale 2026".**

Në takim morën pjesë nga NjVQV:

1. Zëvendëskryetar i Bashkisë, **Z. Mikel Qafa**
2. Sekretar për Këshillin Bashkiak, **Znj. Naze Selimaj**
3. Drejtor për Zyrën e Urbanistikës, **Z. Tonin Prenga**
4. Drejtor për Shërbimet Publike, **Z Pashk Prendi**
5. Anëtare e Këshillit Bashkiak , **Znj. Besjana Marku**

Të pranishëm nga publiku në këtë dëgjese publike janë **banorët e Njesisë Administrative Blerim, të fshatrave Dardhë, Qebik, Truen, Blerim, Kulumri, Xath si dhe kryetarë të fshatrave.**



Fjalën hapëse e mbajti Administratori i Njesisë Administrative Z. Gjovalin Prendi

Ju falenderoj të gjithëve për pjesëmarrjen dhe në veçanti përfaqësuesit e bashkisë për dëgjesën publike të organizuar me banorët e Njesisë Administrative Blerim. Jemi sot këtu në këtë konsultë të hapur mbi Programin Buxhetor Afatmesëm 2026-2028 dhe buxhetin e bashkisë për vitin 2026, për të shpalosur prioritetet e bashkisë për vitin 2026, buxhet që i përket edhe Njesisë tonë. Gjithashtu jemi në këtë konsultë të hapur për të dhënë rekomandimet dhe sugjerimet tona lidhur me shqetësimet e përditshme që kemi në të gjithë sektorët e jetës, për rrugët, për ujin, kanalizimet, ujësjellësat e me radhë, për buxhetin e vitit 2026. Administratori i Njesisë Administrative Z. Gjovalin Prendi e konsideron dëgjesën shumë të rëndësishme në mbështetje të nevojave që kanë banorët e Njesisë Administrative Blerim.



Në vijim fjalën e merr Zëvendëskryetar i Bashkisë, Z. Mikel Qafa:

Z. Qafa informon banorët se ka qenë personalisht në zonë dhe është njohur nga afër me problematikat, si edhe me çështjet e ngritura vazhdimisht në Këshillin Bashkiak nga këshilltarja e zonës, znj. Besjana Marku.



U theksua se shërbimet në qytet janë drejt përfundimit dhe se vëmendja e Bashkisë do të fokusohet në vijim tek njësitë dhe zonat më të largëta.

U nënvizua se zona e Blerimit ka pasur pak mundësi investimesh deri më tani, por viti 2026 do të sjellë ndryshime të ndjeshme në këtë drejtim.

Sa i përket punësimit, u theksua se situata në qendër është përmirësuar, ndërsa në fshatra mbetet e mangët.

Zëvendëskryetari bëri të ditur se së bashku me kryetarin e Bashkisë kanë zhvilluar një takim me Kryeministrin, ku është kërkuar mbështetje dhe investitorë për zhvillimin ekonomik të zonës. Fokusi kryesor i këtij angazhimi është punësimi i banorëve.

U bë me dije se Bashkia po kërkon të sjellë investime private, përfshirë kompani të huaja, në fusha si energjia e rinovueshme.

Në takimin e fundit me Kryeministrin është diskutuar mundësia e ndërtimit të një "Data Center", i cili është vlerësuar si projekt i përshtatshëm për zonën, duke krijuar vende pune me paga të kënaqshme.

Banorët u ftuan të mirëpresin investitorët e huaj, duke u theksuar se pranimi i tyre sjell përfitime të drejtpërdrejta për komunitetin dhe zhvillimin e zonës.

Sa i përket infrastrukturës, zëvendëskryetari siguroi banorët se përmirësimet e rrugëve dhe kërkesat e paraqitura nga kryetarët e fshatrave do të realizohen në gjashtë muajt e parë të vitit 2026, sapo të lejojnë kushtet atmosferike. Tani dua t'ju jap fjalën juve, sepse këtu fillon pjesa më e rëndësishme e këtij procesi.

Është koha që të shprehni kërkesat, rekomandimet dhe sugjerimet tuaja për Buxhetin 2026. Mund të flisni për çdo çështje që lidhet me shpërndarjen e buxhetit, investimet në infrastrukturë, Paketën e Maleve, energjinë e rinovueshme, shërbimet publike, apo çdo ide tjetër që mendoni se ndihmon zhvillimin e bashkisë.

Përveç kësaj dëgjese, mund të na shkruani edhe në faqen tonë zyrtare, në faqen zyrtare të bashkisë: <https://bashkiafushearrez.gov.al/> , email info@bashkiafushearrez.gov.al e cila është e aksesueshme dhe e hapur për të gjithë qytetarët që kanë pyetje, mendime apo propozime.

Gjovalin Prendi, Administratori i Njesisë Administrative Blerim:

Si Administrator i Njesisë Administrative Blerim, po ve theksin në disa nevoja dhe kërkesa të banorëve të Njesisë:

- **Kërkojmë ndihmë bashkisë për rehabilitimin e shtëpisë së Z. Sadri Dervishaj, e djegur plotësisht më 14.11.2026 me të gjitha orënditë shtëpiake.**
- **Rrugët e Njesisë Administrative Blerim, duan hedhje çakulli me kamion nuk është ndërhyrë asnjëherë.**
- **Problematikë mbetet energjia elektrike.**
- **Rikonstruksion i shkollës së fshatit Dardhë.**
- **Kërkohet ndihmë për banorët e lagjes Qebik, kanë vite pa ujë.**
- **Të shtohen mundësitë për punësim në Blerim.**
- **Të ndihmohet financiarisht banori Gazmend Paja, banor i Fshatit Truen të Njesisë Administrative Blerim (i njohur në zonë si Azgani), nuk ka shtëpi, është pa punë dhe në kushte të mjerueshme, ka shumë fëmijë.**

Mikel Qafa, Zëvendëskryetar i Bashkisë:

Jemi informuar për rastin në fjalë, kemi vënë në lëvizje fondin e Emergjencave Civile, po ndiqen procedurat e nevojshme ligjore për dhënie të ndihmës financiare familjes së dëmtuar nga zjarri.

Ka ardhë koha të ndërhyjmë me shërbime të ndryshme. Sapo i kemi siguruar makineritë (edhe një vjen brenda dhjetorit) , viti 2026 do të jetë viti i shërbimeve në Njësitë Administrative.

Sadri Dervishaj, banor i Njesisë Blerim që i është djegur shtëpia:

Falenderoj Bashkinë dhe Emergjencat Civile për procedurat që ka nisë për ndihmë ndaj nesh.

- **Kërkoj para së gjithash të rregullohet rruga që të çon te shtëpia ime, në të kundërt s'kam nga i transportoj materialet e rindërtimit të shtëpisë së djegur sado ndihmë t'më ofrohet.**



Mikel Qafa, Zëvendëskryetar i Bashkisë: Rruga do të rregullohet sa të hapet koha nga reshjet e shiut.

Kristin Ndou, Kryetar i fshatit Qebik:

- **Të ndërtohen dy pusetat e ujësjellësit, janë tejet të vjetra dhe të amortizuara. Përmasat e pusetave janë 2x2, tubin e marrim vetë ne si banorë, shpenzimet e ndërtimit bashkia.**



Muharrem Dervishi, Kryetar i fshatit Blerim:

- **Emergjente rregullimi i rrugës që të çon të shtëpia e Sadri Dervishaj të cilit i është djegur shtëpia.**
- **Të rregullohet mbuloja e shkollës në Blerim, pikon çati. Në atë shkollë mësojnë 17 nxënës.**

Fadil Vela, Kryetar i fshatit Xath:

- **Problematikë në Xath mbetet energjia elektrike, linjat e amortizuara.**

Qazim Baftia, Kryetar i fshatit Flet:

- **Të ndërtohet ura e fshatit që lidh dy lagje;**
- **Problematikë mbetet energjia elektrike ne fshatin Flet;**
- **Rruga për ne fshat nevojë për shërbime;**
- **Të shtohet një punëtor për mirëmbajtjen e rrugës së fshatit Flet.**



Luiz Ndoi, banor i Njësisë Blerim:

- **Të riparohet ose të bëhet puseta e re e ujit të pijshëm;**
- **Të mirëmbahet rruga, shumë e vështirë lëvizja.**

Tonin Prenga, Drejtor për Zyrën e Urbanistikës:

Nuk vlen dhe nuk bëhet puseta ekzistuese, është e vjetër dhe tejet e amortizuar. Duhet një rezervuar 4 tonësh për tu blerë dhe për tu instaluar në shërbim të ujësjellësit.

Shpëtim Bekaj, banor i Njësisë Blerim:

- **Të mundësohen 250 m tub për vijën vaditëse ekzistuese të tokave bujqësore.**

Besjana Marku, anëtare e Këshillit Bashkiak:

- **Të mundësohet përkohësisht një kontenier që të funksionojë si shkollë në Qebik.**
- **Të rikonstruktohet çatia e shkollës së fshatit Dardhë, pikon kur bie shi.**
- **Të shikohet mundësia për një qendër shëndetësore dhe shërbime në fshatin Flet.**
- **Të mundësohet pagesa e transportit të nxënësve të shkollave të Njësisë Blerim.**



Takimi u mbyll me zotimin e Zëvendëskryetarit të bashkisë për të vazhduar bashkëpunimin me komunitetin dhe për të përfshirë shqetësimet e tyre në planifikimin e buxhetit të ardhshëm.



Bashkëlidhur këtij procesverballi, gjendet lista e pjesëmarrësve në këtë dëgjese publike dhe Rekomandimet nga dëgjesa.

SEKRETAR PËR KËSHILLIN BASHKIAK

Naze SELIMAJ



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA FUSHË-ARRËZ
KËSHILLI BASHKIAK

PËR:

- **Z. HIL CURRI, KRYETAR I BASHKISË**
- **KOMISIONIN E EKONOMISË FINANCË-BUXHETIT**
- **KËSHILLIN E BASHKISË FUSHË-ARRËZ**

PËRMBLEDHJE E REKOMANDIMEVE NGA DËGJESA PUBLIKE
NJËSIA ADMINISTRATIVE BLERIM

Lënda: Përmbledhje e rekomandimeve me prioritetet e komunitetit dalë nga konsultimi publik mbi programin Buxhetor Afatmesëm 2026-2028, Buxhetin e Vitit 2026 si dhe Paketën Fiskale 2026, Njësia Administrative Blerim, më 26.11.2025.

Në zbatim të ligjit 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” i ndryshuar, Kalendarit të konsultimit publik, Rregullores për funksionimin e Këshillit Bashkiak, u zhvillua konsultimi publik për programin Buxhetor Afatmesëm 2026-2028, Buxhetin e Vitit 2026 si dhe paketën fiskale 2026, në ambjentet e Njesisë Administrative Blerim.

Qëllimi i dëgjësës: Tërheqja e mendimeve, propozimeve dhe kërkesave për Buxhetin e Vitit 2026, kryesisht për Programin Buxhetor 2026-2028.

Grupet që u konsultuan: Banorët e Njesisë Administrative Blerim, Kryetarët e fshatrave, punonjës të administratës, etj.

Numri i pjesëmarrësve në konsultim: 30 (2 Femra)

Mbështetur në Procesverbalin e dëgjësës publike, mbajtur me datë 26.11.2025

Rekomandimet e dhëna nga banorët e Njesisë Administrative Blerim janë:

- Të ndihmohet financiarisht banori i fshatit Blerim, Sadri Dervishaj, për rehabilitimin e shtëpisë së djegur plotësisht më 14.11.2025 me të gjitha orenditë shtëpiake.
- Rrugët e Njesisë Administrative Blerim, duan hedhje çakulli me kamion.
- Problematikë mbetet energjia elektrike në fshatrat e Njesisë Administrative Blerim.
- Rikonstrukcion i shkollës së fshatit Dardhë.
- Kërkohet ndihmë për banorët e lagjes Qebik, kanë vite pa ujë të pijshëm.
- Të shtohen mundësitë për punësim në Blerim.
- Të ndërtohen dy pusetat e ujësjellësit në fshatin Qebik.

- Të ndihmohet financiarisht Gazmend Paja, banor i Fshatit Truen të Njesisë Administrative Blerim (i njohur në zonë si Azgani), nuk ka shtëpi, është pa punë dhe në kushte të mjerueshme, ka shumë fëmijë.
- Sadri Dervishaj shprehet: “Kërkoj para së gjithash të rregullohet rruga që të çon te shtëpia ime, në të kundërt s’kam nga i transportoj materialet e rindërtimit të shtëpisë së djegur sado ndihmë t’më ofrohet”.
- Emergjente rregullimi i rrugës që të çon të shtëpia e Sadri Dervishaj të cilit i është djegur shtëpia.
- Të rregullohet mbuloja e shkollës në Blerim, pikon çatia. Në atë shkollë mësojnë 17 nxënës.
- Problematikë në Xath mbetet energjia elektrike, linjat e amortizuara.
- Të ndërtohet ura e fshatit Flet që lidh dy lagje ;
- Problematikë mbetet energjia elektrike në fshatin Flet;
- Rruga për në fshatin Flet ka nevojë për mirëmbajtje;
- Të shtohet një punëtor për mirëmbajtjen e rrugës Flet;
- Të riparohet ose të bëhet puseta e re e ujit të pijshëm në Qebik;
- Të mirëmbahen rrugët në Njësinë Blerim, shumë e vështirë lëvizja.
- Të mundësohen 250 m tub për vijën vaditëse ekzistuese të tokave bujqësore (Shpëtim Bekaj).
- Të mundësohet përkohësisht një kontenier që të funksionojë si shkollë në Qebik.
- Të rikonstruktohet çatia e shkollës së fshatit Dardhë, pikon kur bie shi.
- Të shikohet mundësia për një qendër shëndetësore për shërbime në fshatin Flet.
- Të mundësohet pagesa e transportit të nxënësve të shkollave të Njesisë Blerim.

Nga ana e pjesëmarrësve u kërkuar që brenda mundësive të buxhetit, zgjidhja e rekomandimeve të mësipërme të pasqyrohet në buxhetin e vitit 2026 dhe në vazhdim.

Duke kërkuar bashkëpunimin tuaj!

SEKRETAR PËR KËSHILLIN BASHKËKOMUNAL

Naze SELIMAJ





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA FUSHË-ARRËZ
KËSHILLI BASHKIAK

LISTË-PREZENCË PËR PJESËMARRJE NË KONSULTËN PUBLIKE MBI PROGRAMIN
BUXHETOR AFATMESËM 2026-2028, BUXHETIN E BASHKISË PËR VITIN 2026 DHE
PAKETËN FISKALE 2026. NJËSIA ADMINISTRATIVE BLERIM, BASHKIA FUSHË-ARRËZ

Nr.	Emër	Mbiemër	Njësia/Qyteti/Fshati	Pozicioni/Profesioni	Firma
1.	Shyqir	Bekir	Blerim	Functor	
2.	L Kristin	Ndau	Blerim	to fsh. Blerim 1 en so arst	
3.	Pashk	Frush	Bashkua	shk. pub	
4.	Muhamet	Dervishaj	Blerim	3 K/15 shkoll 34 vjet	
5.	Musf	Kadrija	Blerim	punetore	
6.	L Kristin	Ndau	Blerim		
7.	Tej	Tej	Blerim	Teknik Pyjesh	
8.	Qozim	B	Blip		
9.	Fadil	Velaj	Xoth	Krydlokua Xoth	
10.	Azem	Desi	Blerim	Martor	
11.	Bejana	Marku	Dardhë	Mësuese/Këshilltare	
12.	DEJ	LLESHI	BLERIM	SPECIALIST PYJESH	
13.	Gadri	Dervishaj	Blerim	Fermer	
14.	Fran	Demo	Blerim	Teknikë	



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA FUSHË-ARRËZ
KËSHILLI BASHKIAK

LISTË-PREZENCË PËR PJESËMARRJE NË KONSULTËN PUBLIKE MBI PROGRAMIN
BUXHETOR AFATMESËM 2026-2028, BUXHETIN E BASHKISË PËR VITIN 2026 DHE
PAKETËN FISKALE 2026. NJËSIA ADMINISTRATIVE BLERIM, BASHKIA FUSHË-ARRËZ

Nr.	Emër	Mbiemër	Njësia/Qyteti/Fshati	Pozicioni/Profesioni	Firma
1.	GJON MEHMETI	BLERIM	PUNOTS SHERBI		
2.	ZIADA	GJAUARI	BLERIM	PUNONISE NE.	
3.	Alpenta	Velaj	Blerim	S/Finance	
4.	BILBIL MIFTARAJ	BLERIM	PA PUN		
5.	SHENIF DENVISHI	BLERIM	P PUN		
6.	SHKELZEN SYLA	BLERIM	D. P. UNO		
7.	SËFEDIN DËRVIK	BLERIM	PA. PUNO		
8.	HASAN HASANI	BLERIM	PA. PUN		
9.	IZMIR DËRVIK	BLERIM	PUN		
10.	BESIM GJAUARI	BLERIM			
11.	HJAZET PASHA	BLERIM	T.A. PUNO		
12.	FORSHI DËRVIK	BLERIM			
13.	BONIN GJAUARI	Bashkia F-A	Pun.		
14.					

15. Nazet Selimaj Fushë-Arrëz. Sekretarë KB



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA FUSHË-ARRËZ
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 3582 prot.

Fierzë, më 12.11.2025

PROCESVERBAL

**TEMA: KONSULTIM PUBLIK PËR PROGRAMIN BUXHETOR AFATMESËM 2026-2028,
BUXHETI I BASHKISË PËR VITIN 2026, PAKETA FISKALE 2026,
NJËSIA ADMINISTRATIVE FIERZË**

Bazuar në ligjin Nr.139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore" neni 18 pika 1, pika 2, neni 54 germa (dh), germa (f) dhe në Rregulloren për Funkcionimin e Këshillit Bashkiak Fushë-Arrëz (VKB Nr. 15, datë 27.04.2020) Neni 153, Neni 154, **u mbajt sot, më 12.11.2025, në ambientet e Njesisë Administrative Fierzë, Ora:11:00, Dëgjesa publike mbi "Programin Buxhetor Afatmesëm 2026-2028, buxheti i bashkisë për vitin 2026, paketa fiskale 2026".**

Në takim morën pjesë nga NjVQV:

1. Kryetar i Bashkisë, **Z. Ilir Curri**
2. Zëvendëskryetar i Bashkisë, **Z. Mikel Qafa**
3. Sekretar për Këshillin Bashkiak, **Znj. Naze Selimaj**
4. Drejtor për Zyrën e Burimeve Njerëzore, **Znj. Fationa Selimaj**
5. Përgjegjës për Policinë Bashkiake, **Z. Nikolin Qafa**
6. Punonjëse e Policisë Bashkiake, **Znj. Violeta Vuka**
7. Anwtar i Kwshillit Bashkiak, **Z. Nikolin Sadiku**

Të pranishëm nga publiku në këtë dëgjese publike janë banorët e Njesisë Administrative Fierzë, të fshatrave Kokdodë, Mëzi, Fierzë, Arst, Miliska, Porav, Bugjon, Aprripe si dhe kryetarë të fshatrave.



Fjalën hapëse e mbajti Administratori i Njesisë Administrative Z. Ylber Sokoli



Ju falenderoj të gjithëve për pjesëmarrjen dhe në veçanti Kryetarin e Bashkisë Fushë-Arrëz, z. Hil Curri për dëgjuesën publike të organizuar me banorët e zonës, i vetmi Kryetar qysh në vitin 1990 që organizon takime të tilla të hapura, bravo!

Administratori i Njesisë Administrative Z. Ylber Sokoli e konsideron dëgjuesën shumë të rëndësishme në mbështetje të nevojave që kanë banorët e Njesisë Administrative Fierzë.

Z. Ylber Sokoli rendit disa punë të kryera në zonën e Fierzës përmes investimeve nga ana e Bashkisë Fushë-Arrëz nën drejtimin e Kryebashkiakut Hil Curri:

- Është bërë e mundur lidhja e fshatrave Bugjon - Gralisht përmes ndërtimit të urës me të ardhurat e bashkisë;
- Është ndërtuar ura që lidh fshatin Aprripë me qendrën e Njesisë Administrative Fierzë;
- Është rikonstruktuar rruga Bugjon - Urë Drini me makineri të rënda;

Z. Sokoli u shpreh se nuk do të ndalojmë në shërbimet dhe investimet publike falë mbështetjes e bashkëpunimit me Bashkinë Fushë-Arrëz dhe Kryetarin Z. Hil Curri.

Në vijim fjalën e merr **Kryetari i Bashkisë, Z. Hil Curri:**

Faleminderit dhe mirë se keni ardhë në këtë dëgjuesë konsultative ku pjesëmarrja juaj tregon se interesi qytetar dhe padyshim besimi ndaj pushtetit vendor po vjen duke u rritur. Dëgjuesat publike si kjo janë jo vetëm detyrim ligjor por dhe të rëndësishme për një qeverisje pranë qytetarëve. Jemi këtu për të dëgjuar zërin tuaj me vëmendje dhe për të marrë çdo kërkesë dhe nevojë tuajën për shërbime publike në mënyrë që të ndërtojmë një buxhet sa më afër realitetit.



Realisht jemi përball një realiteti i cili kërkon investime të mëdha, përpos kësaj jam optimist

se do të kemi arritje të kënaqshme. Padyshim që çdo kërkesë e juaja është marrë parasysh dhe është pasqyruar në investimet e vitit që po lëmë pas.

Shumë e rëndësishme të marrësh vendime të cilat e zhvillojnë zonën, kjo kërkon forcë e këmbëngulje, një pjesë e madhe janë pro dhe një pakicë mund të jenë kundra.

Sot e 30 vjet akoma merremi me ujë, vija, kanale etj. të cilat duhej të kishin përfunduar me kohë gjatë shërbimeve të legjislativave më parë se të vija unë në krye të Bashkisë.

Banorët kanë pritshmëri të mëdha dhe ju e dini që unë kam bërë përpjekje maksimale dhe do të vazhdoj ta bëj për me gjetë çdo lloj mundësie për t'iu ardhur në ndihmë banorëve të zonës si për realizimin e nevojave që janë kompetencë e bashkisë, ashtu edhe për nevojat që nuk janë kompetencë e bashkisë, besoj fortësisht se nuk do t'ju zhgënjëj.

Klima e investimeve është shumë e mirë dhe në bashkëpunim me kryetarët e fshatrave do t'ia dalim.

Jemi në bisedime me biznesmenë dhe emigrantët dhe ju bëj me dije se do të kemi investime të shumta. Besoj në mbulimin energjetik të zonës me panele Diellore.

Kemi lobuar me Ambasadën Japoneze e cila na ka pasë premtuar për një mjet të ri për kryerjen e punimeve dhe tashmë mjeti fadromë ndodhet në bashkinë tonë në shërbim të banorëve në fshatra më shumë, do marrim edhe një bumkat dhe një kamioncinë për shërbime të ndryshme. Ne do të llojmë të mbajmë këtu banorët dhe gjithashtu për kthimin e banorëve duke ju krijuar kushte normale të jetesës. Me këto mjete do të hyjmë me punime dhe shërbime në çdo rrugë.

Nuk mund të hedhim poshtë punën e pararendësve tanë ku kemi një projekt për asfaltim të rrugëve.

Ne po synojmë që çdo i ri apo e re që është këtu të punësohet e t'i krijohen kushtet normale për jetesë në mënyrë që të ndalojmë sadopak fenomenin e largimit nga vendlindja.

Ne sot jemi këtu të dëgjojmë nevojat dhe kërkesat tuaja ku asgjë nuk është e perealizueshme në mënyrë që të ndërtojmë një program të kompletuar për buxhetin afatmesëm 2026-2028, buxhetin e vitit 2026 si dhe për paketën fiskale 2026 të cilit do t'i hapet drita jeshile për t'u kthyer në vendim në këshillin e bashkisë.

Nuk kam bërë dhe nuk do të bëj asnjë hap pas duke biseduar dhe bashkëpunuar me të gjithë faktorët politik dhe jopolitik, me të gjitha fondacionet, Ambasadat në përmbushje të kërkesave dhe nevojave të qytetarëve si dhe zhvillimin afatgjatë të territorit të bashkisë tone.

Faleminderit që më dëgjuat dhe faleminderit për pjesëmarrjen tuaj, do t'ju dëgjoj me vëmendje dhe do të shënojmë çdo kërkesë dhe nevojë tuajën për shërbime dhe investime.

Përveç kësaj dëgjese, mund të na shkruani edhe në faqen tonë zyrtare, në faqen zyrtare të bashkisë: <https://bashkiafushearrez.gov.al/>, email info@bashkiafushearrez.gov.al e cila është e aksesueshme dhe e hapur për të gjithë qytetarët që kanë pyetje, mendime apo propozime.

Pëllumb Shpendi, banor i fshatit Aprripë:

Ne si banorë të fshatit Aprripë, kërkojmë:

🚧 Hapjen e rrugës së makinës Aprripë-Fierzë.

Nëse është nevoja bashkohemi edhe ne banorët dhe të mundësojmë hapjen rrugës. S'ka rëndësi shtrimi me asfalt, rëndësi ka të hapet si rrugë makine.



Kryetari i Bashkisë Z. Hil Curri:

Unë e kam gjetë një projekt të tillë për hapjen e një rruge nga ura deri në Aprripë, nuk ka ura, bëhet edhe me turbina, nuk ka shtrim asfalti. Shumë shpejt do të dërgohet ky projekt. Për rrugën e Poravit do përpiqemi ta shtrojmë me beton.

Palush Gjoni, Kryetar i fshatit Fierzë:

Duke ju përshëndet, dua ta vazhdoj me kërkesën e banorëve të fshatit Aprripë. Ka ardhë koha të bashkohet Aprripa me Njësinë Fierzë përmes hapjes së një rruge auto.



Falenderoj Kryetarin e Bashkisë Z. Hil Curri si dhe Administratorin e Njesisë Administrative Z.Ylber Sokoli për për bashkërendimin e organizimit lidhur me këtë dëgjese publike.

Ne kërkojmë nga ana jote si Kryetar Bashkie të lobosh deri në Kryeministri për sigurimin e fondeve për shërbimet komunitare.

Ne si banorë të Fierzës kërkojmë:

- ✚ **Shtrimin e rrugës së Fierzës nga ura e drinit deri në qendër të Njesisë me asfalt, përfundimisht ka ardhë koha. Ka ardhë koha që fjalët të bëhen vepër.**

Hil Miceli, banor i Njesisë Fierzë:

- **Më keni premtuar pastrim rruge dhe vazhdoj ta kërkoj përsëri;**
- **Më është ndërprerë ndihma ekonomike, kam aplikuar dhe asgjë akoma;**



Hil Curri, Kryetar i Bashkisë: Sa i përket rrugës, do ta pastrojmë menjëherë sapo të mbërrijë mjeti këtu, ndërsa sa i përket asistencës sociale, ju mbetet vetëm të aplikoni përsëri sepse sistemi i përzgjedh në bazë të kriterëve, ne as nuk shtojmë dhe as nuk heqim askënd, ju duhet të aplikoni përsëri me ndihmën e specialistëve përkatës.

Ylber Sokoli, Administratori i Njesisë Administrative Fierzë:

Unë e di se çfarë rruge është, ajo është rrugë variant, është e pamundur të hyjë manovratori me mjet pastrues. Ndërsa sa i përket Ndhmës Ekonomike, nuk kam asnjë ndikim, ju duhet të delni vetë te zyra e punës dhe të aplikoni.

Mhill Kola, banorë i fshatit Arst: Kam tre kërkesa:

- 🚧 Hapjen e vijës vaditëse të fshatit rreth 3 km;
- 🚧 Rikonstruksionin e rrugës së fshatit;
- 🚧 Hapjen e një pusi për fshatin.

Hil Curri, Kryetar i Bashkisë: Ne do të dërgojmë një grup teknikësh nga bashkia të verifikojë terrenin dhe besoj se do të mundësojmë ndërhyrjen për vijën vaditëse.



Bashkëlidhur këtij procesverballi, gjendet lista e pjesëmarrësve në këtë dëgjese publike dhe Rekomandimet nga dëgjesa.

SEKRETAR PËR KËSHILLIN BASHKIAK

Naze SELIMAJ





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA FUSHË-ARRËZ
KËSHILLI BASHKIAK

PËR:

- **Z. HIL CURRI, KRYETAR I BASHKISË**
- **KOMISIONIN E EKONOMISË FINANCË-BUXHETIT**
- **KËSHILLIN E BASHKISË FUSHË-ARRËZ**

**PËRMBLEDHJE E REKOMANDIMEVE NGA DËGJESA PUBLIKE
NJËSIA ADMINISTRATIVE FIERZË**

Lënda: Përmbledhje e rekomandimeve me prioritetet e komunitetit dalë nga konsultimi publik mbi programin Buxhetor Afatmesëm 2026-2028, Buxhetin e Vitit 2026 si dhe Paketën Fiskale 2026, Njësia Administrative Fierzë, më 10.11.2025.

Në zbatim të ligjit 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” i ndryshuar, Kalendarit të konsultimit publik, Rregullores për funksionimin e Këshillit Bashkiak, u zhvillua konsultimi publik për programin Buxhetor Afatmesëm 2026-2028, Buxhetin e Vitit 2026 si dhe paketën fiskale 2026, në ambjentet e Njesisë Administrative Fierzë.

Qëllimi i dëgjësës: Tërheqja e mendimeve, propozimeve dhe kërkesave për Buxhetin e Vitit 2026, kryesisht për Programin Buxhetor 2026-2028.

Grupet që u konsultuan: Banorët e Njesisë Administrative Fierzë, Kryetarët e fshatrave, punonjës të administratës, etj.

Numri i pjesëmarrësve në konsultim: 24 (3 Femra)

Mbështetur në Procesverbalin e dëgjësës publike, mbajtur me datë 10.11.2025

Rekomandimet e dhëna nga banorët e Njesisë Administrative Fierzë janë:

- **Hapja e rrugës së makinës Aprripë-Fierzë.**
- **Shtrimi i rrugës së Fierzës nga Ura e Drinit deri në qendër të Njesisë me asfalt.**
- **Hil Miceli kërkon pastrimin e rrugës që të çon në shtëpinë e tij.**
- **Hil Miceli kërkon rilidhjen e ndihmës ekonomike.**

- Hapja e vijës vaditëse të fshatit Arst rreth 3 km, Njësia Administrative Fierzë.
- Rikonstruktion i rrugës së fshatit Arst, Njësia Administrative Fierzë.
- Hapja e një pusi për fshatin Arst, Njësia Administrative Fierzë.

Nga ana e pjesëmarrësve u kërkua që brenda mundësive të buxhetit, zgjidhja e rekomandimeve të mësipërme të pasqyrohet në buxhetin e vitit 2026 dhe në vazhdim.

Duke kërkuar bashkëpunimin tuaj!

Sekretar për Këshillin Bashkiak

Naze SELIMAJ





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA FUSHË-ARRËZ
KËSHILLI I BASHKISË

LISTË-PREZENCË PËR PJESËMARRJE NË KONSULTË PUBLIKE ME TEMË: PROGRAMI
BUXHETOR AFATMESËM 2026-2028, BUXHETI I BASHKISË PËR VITIN 2026 DHE
PAKETA FISKALE 2026.

Nr.	Emër	Mbiemër	Njësia/Qyteti/Fshati	Pozicioni/Profesioni	Firma
1.	Mikel	Dafa		Zv. kryetar	
2.	Ylber	Sokoll			
3.	Gonim	Zepe			
4.	SOKOL	IBRAH			
5.	Gjergj	Stol			
6.	Donat	Bekir			
7.	Ymer	Kung			
8.	Katrin	Kami			
9.	Hit	U. Ueli			
10.	Luom	Sokoll			
11.	E. Lodon	Megjini			
12.	Palush	Gjoni			
13.	Skol	Spende			
14.	Deed	Elzeri			



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA FUSHË-ARRËZ
KËSHILLI I BASHKISË

LISTË-PREZENCË PËR PJESËMARRJE NË KONSULTË PUBLIKE ME TEMË: PROGRAMI
BUXHETOR AFATMESËM 2026-2028, BUXHETI I BASHKISË PËR VITIN 2026 DHE
PAKETA FISKALE 2026.

Nr.	Emër	Mbiemër	Njësia/Qyteti/Fshati	Pozicioni/Profesioni	Firma
1.	Gjeh Fasha	Porolt			
2.	Mhill Kola				
3.	Nikolina	Sadilva			
4.	Gjelosh	Yela			
5.	Pol	Miceli			
6.	Naze Selimaj	Fushë-Arrëz		Sekretare e KB.	
7.	Fotiana Selimaj	Fushë-Arrëz		Drejtore e Burmëve Njëzore	
8.	Hil Curri	Bashkia F-Arrëz		Kryetar Bashkie	
9.					
10.					
11.					
12.					
13.					
14.					



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA FUSHË-ARRËZ**

Adresa: Fushë-Arrëz, Rruga Qender, email: info@bashkiafushearrez.gov.al



Fushe-Arrez, me 26.11.2025

MATERIAL PERMBLEDHES

“Mbi

problematikat e ngritura ne degjese publike te dates 26.11.2025, ne Njesine Administrative Iballe, per Programin Buxhetor Afatmesem 2026-2028, Buxhetin e Bashkise per vitin 2026, si dhe Paketën Fiskale 2026”.

Me date 26.11.2025, ora 11.00, ne Njesine Administrative Iballe u zhvillua degjese publike per Programin Buxhetor Afatmesem 2026-2028, Buxhetin e Bashkise per vitin 2026, si dhe Paketën Fiskale 2026.

Ne takim moren pjese; Z.Hil CURRI Kryetar I Bashkise Fushe-Arrez, Z.Akil ZMALAJ, Administrator I Njesise Administrative Iballe, Znj.Fationa SELIMAJ, Drejtoreshe e Burimeve Njerzore ne Bashkine Fushe-Arrez, Znj.Redona HASANI, Pergjegjese e Zyres Juridike ne Bashkin Fushe-Arrez, Znj.Paola QAFA, Pergjegjese e Zyres se Planifikimit te Territorit ne Bashkine Fushe-Arrez, Z.Aldi LEPURI, Specialist I Zyres Juridike, Zj.Jetmira MURATAJ, Specialiste e Zyres se Planifikimit te Territorit ne Bashkine Fushe-Arrez, Z.Nikolin QAFA, Pergjegjes I Policise Bashkiake.

-Nga Njesia Administrative Iballe, te pranishem ishin personeli I Njesise si dhe banore te Njesise Administrative qe perfshijne pothuajse te gjithe fshaterat si; Iballe, Mertur, Berishe e Eper, Levoshe, Berishe e Vogel, Sapaç, Shopel, Berishe Vendi.

-Takimi u hap nga Administratori I Njesise Iballe, Z.Akil ZMALAJ, I cili citoi se;
-Une nuk jam ne postin e Administratorit per karriere politike, por per tu sherbyer te gjithe komunitetit te Njesise, me me te miren e mundeshme nga ana ime dhe me mbeshtetjen e Kryetarit te Bashkise dhe Administrates se tij.

- Degjësia publike, tashmë janë bërë e për viteshme jo vetëm për Buxhetin dhe Paketën Fiskale, por edhe për problem të tjera që shqetësojnë Komunitetin,
- Njësia Administrative Iballe, ka një shtrirje të madhe gjeografike, dhe përpjekja dhe angazhimi i yne ka qenë maksimal për të bërë me të mirën e mundeshme për komunitetin që përfaqësojmë. Për këtë një falenderim i veçantë shkon për Kryetarin e Bashkisë për vëmendjen e shtuar ndaj nesh, për të ngritur zërin në Institucionet përkatëse dhe të bërë me të mirën e mundeshme për ne.

Problemet e ngritura nga Administratori;

- Infrastruktura rrugore, sidomos ajo e rrugëve rurale, ka probleme, pasi Zona është shumë e hapur dhe nuk mund të vihet menjëherë në dispozicion secilit banor që ka apo mund të ketë probleme, kjo jo se na mungon vullneti dhe përkushtimi, por nuk i kemi mundësitë me buxhetin dhe me mjete.
- Infrastruktura arsimore, është e mirë, por si rezultat i levizjeve demografike, po shkon drejt venitjes.
- Infrastruktura Shëndetësore, edhe kjo po venitët nga dita në ditë si pasojë e levizjeve demografike;
- Investimet nuk kanë qenë në nivelin e duhur, kjo për mungesë të gjetjes së financimeve të nevojshme;
- Hapja e rrugës auto që lidh fshatin Berishtë e Vogel me Zvinen dhe Liçenin e Komanit;

- Zj.Tereze DEMA**, anetare e Këshillit Bashkiak të Bashkisë Fushe-Arrez, u shpreh se;
- E kam ngritur zërin dhe do vazhdoj ta ngre për çdo shqetësim dhe problem deri në realizimin e tyre.

Z.Hil CURRI, Kryetari i Bashkisë Fushe-Arrez, u shpreh;

- Këtë degjësi publike me Komunitetin, janë një vazhdimësi e punës tone, me qëllim që të thithim edhe mendimet e sugjerimet e qytetarëve për vendim marrjeve të mëdha siç janë; Buxheti afatmesëm, Buxheti dhe Paketa Fiskale për vitin 2026.
- Une kam qenë, jam dhe do të jemë i gatshëm dhe i predispozuar për të shërbyer me të gjitha mundësitë që kam, me po aq dashuri sa keni ju banorët e Iballes për Njësine Tuaj.
- Gjeje rastin të falenderoj 2 anëtarët e Këshillit Bashkiak të Njësise Iballe, që edhe pse me bindje të kundërta, kemi gjetur mënyrën e bashkëpunimit të përbashkët dhe shumë korrekte për çdo të mirë të realizuar në Njësine Iballe.
- Situata e gjetur, kur mora drejtimin e Bashkisë, ka qenë shumë e vështirë, si nga ana financiare, ashtu dhe nga ajo administrative, kështu që fati jo e vogël ka qenë edhe nga Iballa.

-Kemi shlyer nje fature te madhe detyrimesh te lene nga ata qe ishin para nesh.
-Jam kritikuar per te mos thene akuzuar nga kolege, shok dhe miq per mos berje reforme ne administrate, por une I kam qendruar dhe do I qendroj fort asaj se kjo Bashki ka dhe do te kete nevoje ne radhe te pare per keto qe kemi, pamvaresisht preferencave politike.

-Iballia, ka potenciale te medha Intelktuale dhe Biznesmen te fuqishem dhe qe jane rezultativ ne te gjithë territorin e vendit dhe qe duhet te kthehen ne lobues te te fuqishem te zones se tyre, pasi Zona eshte nje dhurat e natyres me resurse te jashtezakonshme per zhvillim.

-Nga ana e Bashkise, jane bere studime, plane zhvillimore dhe lobime per Zonen e Gjelber, energjine fotovoltaike dhe ate Eulike.

-Kemi nje rritje te ndjeshme te te ardhurave, krahasuar me realizimet e mepareshme.

-Kemi 3 Impiante te prodhimit te ujit te pishem, dhe qytetaret nuk pranojne te punojne, por kete privilegj nuk e kane banoret e Njesise Iballe.

-Prioritet per ne jane;

-Zhvillimi I Komunitetit;

-Mos shpopullimi I Zones;

Kjo do ndodhe ne saj te punes paraprake dhe asaj qe do bejme ne vazhdimesi, si me zhvillimin e territorit nepermjet ndertimit te Impianteve fotovoltaike, atyre Eulike, Hidrocentraleve te vegjel, ku vetem ne territorin e Iballes jane dhene 3 leje, ashtu edhe nepermjet zbatimit te Paketes se Maleve per zhvillimin e pronave, ku ne jemi shume optimist.

-Njesia Administrative Iballe, nuk ka qene e ndare apo e diferencuar nga Njesite e tjera.

-Rregullimi dhe mirembajtja e rruges eshte prioritet I yni, pasi eshte hedhur tre here ne tender, por asnje Operator nuk ka shfaqur interes me ate shume lekesh. Gjithesesi shuma e lekeve eshte e ruajtur dhe e gateshme per financim ne vitin ne vazhdim.

-Resurset dhe burimet jane te medha, pasi gati 2/3 e territorit te Bashkise pershkohet nga basenet e Liçenit te Fierzes dhe Komanit si dhe Minierat, per te cilat pushteti vendore merr shum pak, per te mos thene aspak te ardhura vendore.

-PROBLEMET E NGRITURA NGA BANORET;

-Alfred MATOSHI;

-A ka strategji konkrete per ringjalljen ekonomike te Bashkise, nese po, cili eshte perfitimi I komunitetit.

-A ka ndonje negocim lidhur me rrugen auto qe lidhet me Tropojen, çfare eshte bere deri tani.

- A mos keto Fabrika qe marrin ujin e ketyre maleve, nje pjese te fitimit te tyre ta rikthejne ne keto male, me mbjellie pemesh.
- Duhet rritur kerkesa e llogarise per personelin, pasi ka punonjes qe marrin rrogen dhe nuk dalin tek puna, pa hyre tek performanca e tyre.
- Problemi i mbetjeve dhe menaxhimi i tyre, eshte nje shqetesim serioz dhe qe kerkon zgjidhje sa me te shpejte.
- Furnizimi me energji elektrike, lene shume per te deshiruar.
- Eshte ndertuar nje Ure qesharake dhe me nje vlere te larte financiare.
- A eshte parashikuar per ndricimin publik ne fshatin Iballe, nese lidhet Kontrata nga Bashkia, une marr persiper Lagjen Koprat.
- A eshte planifikuar ndonje nisem per dekorin e festave te fundvitit per fshatin Iballe.

-Florian VATA;

- Njesia Administrative Qafe Mali dhe Fierze, kane numerin me te larte te te punesuarve.
- Sa leke i jane dhene Njesise Administrative Iballe;
- Punonjesit e rrugeve rurale, nuk dalin ne pune dhe rroga u ecen.
- A ka Bashkia punonjes qe jetojne ne Tirane dhe marrin rrogen ketu tek ne!

-Gjelosh VUKZAJ:

- Kam problem per vijen vaditese;
- Pastrimi i rrugeve nga mbetjet;
- Nje Urc per kalim kembesore per ne shtepi

-Ndue VATGJONI;

- Rruga eshte bere e pakalueshme si pasoje e reshjeve te rena.
- Hapja e rruges per ne Zvinc (ketu do te kontribojme edhe ne perfituesit)

-Kristjan SOKOLI (Lagjia Ludrice Iballe);

- Jemi e vetmja lagje qe nuk ka patur asnje investim si nga Bashkia apo nga ndonje subjekt privat.
- Kerkojme 300 ml tub per kanalin vadites te lagjes.

-Ndoc PEMATI;

- Te bahet Ura per kalimin e kembesoreve (te me sillet derrasa, pasi uren e baj vete).

-Fatmir SULEJMANI;

- Duhet ndryshim tumbinash tek ura. Rrafshuar me beton.

-Vasil SUTA;

-kam problem ndertimin e nje Ure kembesore, pasi nuk kan nga kalojne femijet per ne shkolle.

-Pllumb VATA;

-Kemi problem venjen ne funksionim te Vades se Malutes, e cila kerkon nderhyrjen dhe mbeshtetjen Tuaj.

-Mirash MARKU;

-Ura, ka nevojë për riparimin me beton të shpatullave të saj, si dhe ndryshimin e tumbinave (duhen 6 cope).

-Ndue NIKA;

-Kemi problem se investimi në Kanalin Vadites është bërë, por nuk vjen uji nga Rezervuari.

Fationa SELIMAJ





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA FUSHË-ARRËZ
KËSHILLI BASHKIAK

LISTË-PREZENCË PËR PJESËMARRJE NË KONSULTËN PUBLIKE MBI PROGRAMIN
BUXHETOR AFATMESËM 2026-2028, BUXHETIN E BASHKISË PËR VITIN 2026 DHE
PAKETËN FISKALE 2026. NJËSIA ADMINISTRATIVE IBALLE, BASHKIA FUSHË-ARRËZ

Nr.	Emër	Mbiemër	Njësia/Qyteti/Fshati	Pozicioni/Profesioni	Firma
1.	Azim Cemel		Iballe	Specialist i Mbrojtjes	
2.	Grim Hajdari		—	punës	
3.	Victor Myroka			punës	
4.	Povlin Shtori			punës	
5.	Alfred Matoshi			Junist	
6.	Ndoc Pemat		Kryepik. Iballe 0686971003	Pensionist	
7.	Josif Jetroj			punës	
8.	Nolue Miko				
9.	Astrit Hoxha		-11-	P. Pyjok.	
10.	Armond Mëdaj		-11-	P. Pyjok	
11.	Argjesh Dërraj				
12.	XHEVAHIR			ALIAJ	
13.	Boris Dge			zuel	
14.	Gerard Zef			Weg	



Iballe, më 26. 11. 2025

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA FUSHË-ARRËZ
KËSHILLI BASHKIAKLISTË-PREZENCË PËR PJESËMARRJE NË KONSULTËN PUBLIKE MBI PROGRAMIN
BUXHETOR AFATMESE 2026-2028, BUXHETIN E BASHKISË PËR VITIN 2026 DHE
PAKETËN FISKALE 2026. NJËSIA ADMINISTRATIVE IBALLE, BASHKIA FUSHË-ARRËZ

Nr.	Emër	Mbiemër	Njësia/Qyteti/Fshati	Pozicioni/Profesioni	Firma
1.	Emir	Jan	Laraj		
2.	Altin	Tepell		Rreze	
3.	Ardit	Deda	Iballe	Punëtor shërbime	
4.	Kristjan	Sokolaj	Ludric		
5.	Mirash	Moraku			
6.	Pashk	Ndroskoc			
7.	Ndue	Vatojuni	Kryepik	K. Plak	
8.	Mhill	Bedaj		Plak logje	
9.	Florian	Vata		banor	
10.	Gjelosh	Vukraj		shofer	
11.	Astrit	Sokolaj		kplotk levojsh	
12.	Pllumb	Vata		Mesues	
13.	Pashk	Mirashi		banor	
14.	Altin	Pershpalaj		K. plak shqep	



Iballe, më 26. 11. 2025

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA FUSHË-ARRËZ
KËSHILLI BASHKIAK

LISTË-PREZENCË PËR PJESËMARRJE NË KONSULTËN PUBLIKE MBI PROGRAMIN
BUXHETOR AFATMESE 2026-2028, BUXHETIN E BASHKISË PËR VITIN 2026 DHE
PAKETËN FISKALE 2026. NJËSIA ADMINISTRATIVE IBALLE, BASHKIA FUSHË-ARRËZ

Nr.	Emër	Mbiemër	Njësia/Qyteti/Fshati	Pozicioni/Profesioni	Firma
1.	Gezim	Mhilli		Rrugët rurale	
2.	Fortmir	Sulejmani		Roje	
3.	Tom	Marku		Roje	
4.	Vasil	Sutaj		banor	
5.	Astut	Aga			
6.	Tekere	Demir	Iballe	ulësues	Jemov
7.	Aldi	deparri		Jurist	
8.	Bedmir	Murataj		Inzhinier	
9.	Redona	Hasoni		Juriste	
10.	Fatjona	Selimgj		Juriste	
11.	Hil	Curri	Bashkia F-Arrëz	Kryetar Bashkie	
12.					
13.					
14.					